



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Qershor 2016

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Qershor 2016

© Ministria e Financave, 2016

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [eva.doda@financa.gov.al](mailto:eva.doda@financa.gov.al)  
[vivi.besho@financa.gov.al](mailto:vivi.besho@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin qershor 2016 arriti në 100.19 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin qershor 2016 ishte 1.2 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin qershor 2016 ishte 122.76 lekë për dollarë dhe 137.92 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit qershor 2016 shënuan kuotat 0.73 për qind për ato 12-mujore, 0.54 për qind për 6-mujoret ,0.28 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.72 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.19 për qind për huatë 12-mujore dhe 10.08 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,205,559.2 milionë lekë në muajin qershor , duke shënuar një rritje prej rreth 0.6 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm pagesave* për tremujorin e parë të 2016-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), pra deficit, prej rreth 49.5 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-qershor 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 17.9 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 22.8 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar -4.8 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2016, arritën në rreth 198.1 miliardë lekë ose afërsisht 100.1 për qind e planit për muajin qershor .
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 180.1 miliardë lekë ose 88.8 për qind e shpenzimeve të planifikuara për muajin qershor .


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin qershor 2016 ishte +1.2 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 1.4%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin qershor 2016 shënoi rënie prej 0.6 për qind krahasuar me muajin maj 2016. Ky indeks ka shënuar gjithashtu rënie prej 0.4 në muajin prill. Ndërsa në muajt mars, shkurt dhe janar ky indeks ka shënuar rritje respektivisht prej 0.5; 1.1 dhe 0.9 krahasuar me muajin paraardhës. Një vit më parë ky indeks ka pasur të njëjtën tendencë rënie për muajt qershor dhe maj me përkatisht 1.7 dhe 1.6 për qind.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Transport” me një rritje vjetore të çmimit prej -3.6%, duke kontribuar me -0.23 pikë përqindje; “Veshje dhe këpucë” me një rritje vjetore të çmimit prej -1.5%, duke kontribuar me -0.1 pikë; “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me një rritje vjetore të çmimit prej -0.1%, duke kontribuar me -0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%. Rritja më të madhe gjatë muajit qershor u konstatua në kategorinë “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej



+2.7%, duke kontribuar me +0.97 pikë përqindje; “Shërbimi arsimor” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.8%, duke kontribuar me +0.19 pikë përqindje; “Pije alkoolike dhe duhan” me një rritje vjetore të çmimit prej +1.4%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1.2%.

Ndryshimi mujor i indeksit është -0.6 %. Krahasuar me muajin maj 2016, ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije alkoolike” me 1,9 %.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4	1.3	1.9	2.2	2.1	2.1	2.0
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2						

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin qershor 2016, arriti në 137.92 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.3 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit qershor, një euro u këmbye me 137.33 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin qershor 2016 arriti në 122.76 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.3 për qind kundrejt muajit maj 2016. Në fund të muajit qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 123.5 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 2.3 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se është nënçmuar në masën 2.1 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës amerikane dhe evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.9 dollarë/euro duke ruajtur të njëjtin nivel të muajit të mëparshëm. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.



### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit qershor 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 0.73 dhe 0.54 për qind duke shënuar respektivisht rënie prej 0.11 dhe 0.13 pikë përqindje krahasuar me muajin maj 2016. Rënie për këtë muaj kanë shënuar edhe normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore duke arritur respektivisht në nivelin 0.28, ndërsa ato me afat maturimi 1-mujore shënuan rritje prej 0.05 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej 0.90 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 1-mujor që kanë arritur nivelin 0.72 për qind për qershor 2016, pasuar nga depozitat me afat të maturimit 12-mujor me rënie vjetore prej 0.72 pikë përqindje.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit qershor 2016 shënoi rënie me 1.1 pikë përqindje krahasuar me muajin maj 2016, duke arritur në nivelin 7.19 për qind. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 0.29 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 10.1 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit qershor 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 0.95 dhe 1.28 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie mujore në *yield*-in e këtyre bonove të thesarit përkatësisht me 0.04 dhe 0.07 pikë përqindje.



## 4. Bilanci i Pagesave



Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2016 shënoi rënie të mjeteve valutore, pra deficit, me rreth 50 milionë euro. Tremujori i parë i 2016-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej 258 milionë euro, me një rritje prej 8% kundrejt tremujorit të parë të vitit 2015. Në krahasim me një vit më parë, deficitin e tregtisë së mallrave u rrit me 18% duke arritur në 576 milionë euro. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto pozitiv prej rreth 123 milionë euro dhe kanë mundur të reduktojnë deficitin korrent në masën 48%. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Llogaria korrente për tremujorin e parë të vitit 2016 thelloi deficitin e saj në rreth 1,918 milionë euro, ose 1% më të larta referuar tremujorit të parë në vitin 2015. Thellimi i deficitit korrent i atribuohet zgjerimit të deficitit tregtar në mallra me 87 milionë euro, si dhe rënies së tepricës pozitive të llogarisë së të ardhurave dytësore me 19 milionë euro.

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej 258 milionë euro shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2016:

- (i) bilanci tregtar me -576.1 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 175.9 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 18.8 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 161.3 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.





## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit qershor 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 94,665 miliardë lekë krahasuar me muajin qershor të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 72,735 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 21,930 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,205,559.2 milionë lekë në muajin qershor, duke shënuar rritje prej rreth 0.6 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin qershor 2016, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 32,115 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin maj 2016. Rritja për këtë muaj, krahasuar me muajin paraardhës ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes mujore së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me 36,583 miliardë lekë.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin qershor 2016 arriti në 552,211.1 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin qershor 2015 shënoi rënie me vlerë 158.0 miliardë lekë, pra rënie prej rreth 0.03 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 54.9 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 303,424 milionë lekë.

Gjatë muajit qershor 2016, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.0 për qind ose 359,162 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28.4 për qind ose 156,841 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.8 dhe 1.6 për qind apo 26,276 dhe 9,052 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin qershor 2016, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 53.36 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 35.57 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.62 për qind dhe rreth 22.53 për qind.



## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin qershor 2016 shënoi rritje me 0.16 për qind krahasuar me muajin paraardhës maj 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 229,227.2 milionë lekë në fund të muajit qershor 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin qershor 2015 prej 0.11 për qind.

Fig-11



**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin qershor 2016, kanë pësuar rënie prej 13,994.8 milionë lekë në krahasim me muajin qershor 2015. Depozitat në valutë gjatë muajit qershor 2016 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 84.4 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë, sektori i individëve ka zënë rreth 87.4 për qind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit qershor 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.4 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.4 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 2.0 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 84.4 për qind dhe rreth 13.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 85.9 për qind e totalit.

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 838,728.9 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (112,547.9 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (14,207.1 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (8,956.7 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1,931.4 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



**Përberja e depozitave Qershor 2016**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit qershor 2016, niveli i përgjithshëm i depozitave krahasuar me një muaj më parë, shënoi rritje prej 1,013.9 milionë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar gjithashtu rritje me 4,967 milionë lekë.


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-qershor 2016 janë mbledhur rreth 198.1 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 180.1 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 161.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 18.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 59% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 133.6 miliardë lekë (ose rreth 101% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 8.1 miliardë lekë (ose rreth 88% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 38.0 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 13.4 miliardë lekë (ose rreth 91% e planit të periudhës janar-qershor ).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 161.8 miliardë lekë, 33.2 miliardë lekë (21% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 17.5 miliardë lekë (11%) për interesat, 16.5 miliardë lekë (10%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 631



milionë lekë (0.4%) për subvencione, 69 miliardë lekë (43%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 15.2 miliardë lekë (9%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 9.5 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 47% (shpenzime personeli), 41% (shpenzime për interesat), 38% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 36% (subvencione), 45% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 31% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe 40% shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 35%, ndërsa financimi i huaj është 27% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-qershor 2016 ishin rreth 198.1 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 180.7 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 13.4 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës janar-qershor 2016 (mld Lekë)*  
*Revenues during January-June 2016 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	Qershor '16 June '16	Qershor'15 June'15	Ndrysh(% Chang (%)
TVSH (VAT)	62.8	58.0	8.3
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	16.5	13.6	21.8
Taksa doganore (Custom Tax)	2.8	2.6	8.0
Taksat nacionale (National Tax)	16.2	15.0	8.1
Akcizat (Excise)	19.2	17.4	10.3
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	16.0	13.5	18.1

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Qershor – 2016;*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: June – 2016;*

## 1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 18 miliardë lekë, përgjatë periudhës janar-qershor 2016, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme (rreth 145% të totalit të suficitit) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 34% të totalit të suficitit).

Për muajin qershor 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 33.792 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 33.403 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin qershor 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 30.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 30.2 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3.2 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1																			
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
Janar	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	0.80	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	January
Shkurt	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	1.55	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	February
Mars	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5	1.00	0.8	0.77	0.9	1.4	0.7	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	0.3	March
Prill	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4	0.60	0.6	0.55	0.5	0.9	0.5	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	0.3	April
Maj	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2	0.26	0.3	0.24	0.2	0.3	0.2	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	0.7	May
<b>Qershor</b>	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	<b>-0.6</b>	0.04	0.1	0.15	0.1	0.1	<b>0.04</b>	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	<b>1.2</b>	<b>June</b>
Korrik	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7		-0.07	0.1	-0.03	0.0	0.1		3.6	2.7	1.6	1.8	1.3		July
Gusht	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8		-0.02	0.1	-0.04	0.0	0.1		3.1	2.8	1.2	2.0	1.9		August
Shtator	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6		0.02	0.1	0.06	0.0	0.2		2.8	2.6	1.7	1.5	2.2		September
Tetor	0.4	0.2	0.1	0.1	0.01		0.06	0.1	0.05	0.0	0.2		3.0	2.4	1.7	1.4	2.1		October
Nëntor	0.1	0.2	-0.5	-0.2	-0.3		0.06	0.1	0.01	0.0	0.1		2.9	2.5	1.0	1.7	2.1		November
Dhjetor	1.0	0.9	1.7	0.7	0.6		0.14	0.2	0.15	0.1	0.17		1.7	2.4	1.9	0.7	2.0		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2011	2012	2013	2014	2015	2016						Currency
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
<i>Mesatarja e periudhës</i>												<i>Average of period</i>
USD	100.90	108.18	105.67	113.64	126.64	127.37	124.70	124.56	122.21	122.35	122.76	USD
EURO	140.33	139.04	140.27	140.11	137.65	138.35	138.33	138.22	138.51	138.32	137.92	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>												<i>In the end of period</i>
USD	107.54	105.85	101.86	115.23	125.79	127.06	126.59	122.26	121.56	124.15	123.50	USD
EURO	138.93	139.59	140.20	140.14	137.28	138.68	138.24	138.77	138.29	138.32	137.33	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2011	2012	2013	2014	2015	2016						In percent
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	
						Jan	Feb	Mar	Apr	May	June	
<b>Norma e depozitave</b>												Deposits rates
12-M	5.87	5.38	4.17	1.51	1.27	1.18	1.15	1.07	0.93	0.84	0.73	12-M
6-M	4.87	4.50	3.40	1.16	1.17	0.90	0.74	0.78	0.65	0.67	0.54	6-M
3-M	4.22	3.83	2.72	0.83	0.54	0.50	0.51	0.39	0.33	0.29	0.28	3-M
1-M	4.39	3.62	2.79	1.47	0.88	1.14	0.56	0.49	0.72	0.67	0.72	1-M
<b>Norma e huasë</b>												Lending rates
12-M	11.17	10.28	9.52	7.00	7.47	8.29	7.31	7.47	4.29	8.30	7.19	12-M
6-M	12.28	10.61	9.59	8.18	8.35	9.24	9.48	9.28	9.67	9.79	10.08	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>												Securities rates
Bono thesari 1/												Treasury bills 1/
3-M	5.31	5.03	3.40	3.15	-	1.45	-	-	0.90	-	-	3-M
6-M	6.23	5.65	3.54	3.16	2.46	1.99	1.36	1.26	1.15	0.99	0.95	6-M
12-M	6.95	6.37	3.66	3.33	2.40	2.10	1.78	1.63	1.52	1.35	1.28	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>32,829</b>	<b>61,725</b>	<b>96,639</b>	<b>131,304</b>	<b>164,324</b>	<b>198,116</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>335</b>	<b>1,655</b>	<b>2,542</b>	<b>3,303</b>	<b>3,895</b>	<b>3,944</b>	<b>Grants</b>
<b>II.</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>29,799</b>	<b>55,728</b>	<b>88,166</b>	<b>119,583</b>	<b>150,151</b>	<b>180,741</b>	<b>Tax Revenue</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>21,355</b>	<b>40,944</b>	<b>66,560</b>	<b>88,241</b>	<b>110,315</b>	<b>133,672</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,195	19,861	29,912	40,474	51,357	62,817	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,556	3,416	10,787	12,814	14,551	16,556	Profit Tax
3	Akcizat	2,789	5,561	8,588	11,967	15,385	19,201	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,345	5,752	7,967	10,553	13,429	16,002	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,072	5,546	7,999	10,659	13,286	16,244	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	398	808	1,307	1,774	2,307	2,852	Customs Duties
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>643</b>	<b>1,202</b>	<b>2,217</b>	<b>4,193</b>	<b>6,784</b>	<b>8,125</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	193	351	650	1,438	2,316	2,880	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	74	170	431	493	519	543	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	376	681	1,136	2,262	3,949	4,702	Local Taxes
<b>II.3</b>	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>7,801</b>	<b>13,582</b>	<b>19,389</b>	<b>27,149</b>	<b>33,052</b>	<b>38,944</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	6,551	11,371	16,242	22,714	27,677	32,673	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,144	1,895	2,630	3,752	4,556	5,337	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	106	316	517	683	819	934	Revenues for property compensation
<b>III.</b>	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,695</b>	<b>4,342</b>	<b>5,931</b>	<b>8,418</b>	<b>10,278</b>	<b>13,431</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	0	0	1,095	1,095	1,095	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,006	3,113	4,223	5,490	6,923	9,423	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	0	2	2	10	11	21	Divident
4	Tarifat shërbimeve	513	653	788	1,004	1,155	1,326	Tariffs on services
5	Të tjera	176	574	918	819	1,094	1,566	Other/not allocated
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>23,898</b>	<b>51,678</b>	<b>83,547</b>	<b>116,144</b>	<b>146,727</b>	<b>180,130</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>22,490</b>	<b>48,531</b>	<b>75,313</b>	<b>103,951</b>	<b>131,644</b>	<b>161,856</b>	<b>Current Expenditures</b>
<b>I.1</b>	<b>Personell</b>	<b>5,430</b>	<b>10,918</b>	<b>16,463</b>	<b>22,061</b>	<b>27,622</b>	<b>33,251</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	4,657	9,376	14,148	18,965	23,755	28,596	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	773	1,542	2,315	3,096	3,867	4,655	Social insurance contributions
<b>I.2</b>	<b>Interesat</b>	<b>3,305</b>	<b>6,576</b>	<b>9,282</b>	<b>12,174</b>	<b>14,776</b>	<b>17,451</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,481	5,105	7,338	9,572	11,715	13,819	Domestic
2	Të Huaja	824	1,471	1,944	2,602	3,061	3,632	Foreign
<b>I.3</b>	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,204</b>	<b>3,752</b>	<b>6,528</b>	<b>9,376</b>	<b>12,362</b>	<b>16,511</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
<b>I.4</b>	<b>Subveclonet</b>	<b>54</b>	<b>100</b>	<b>273</b>	<b>339</b>	<b>417</b>	<b>631</b>	<b>Subsidies</b>
<b>I.6</b>	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>10,264</b>	<b>21,510</b>	<b>32,856</b>	<b>44,843</b>	<b>56,958</b>	<b>69,347</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	8,332	16,643	25,362	34,245	43,089	52,478	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	1,932	4,669	7,296	10,400	13,434	16,434	Health insurance
3	Fondi I kompensimit te pronareve	0	198	198	198	435	435	Expenditures for Owners Compensation
<b>I.7</b>	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>1,399</b>	<b>3,365</b>	<b>5,729</b>	<b>9,122</b>	<b>11,761</b>	<b>15,202</b>	<b>Local budget expenditure</b>
<b>I.8</b>	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>834</b>	<b>2,310</b>	<b>4,182</b>	<b>6,036</b>	<b>7,748</b>	<b>9,463</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	41	85	133	188	262	334	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	801	1,956	3,782	5,552	7,002	8,615	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	-8	269	267	296	484	514	Compensation for ex-political prisoners
<b>III</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,408</b>	<b>3,147</b>	<b>8,234</b>	<b>12,193</b>	<b>15,083</b>	<b>18,274</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	46	474	4,020	6,247	7,825	10,749	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,362	2,673	4,214	5,946	7,258	7,525	Foreign financed
<b>V.</b>	<b>DEFICITI</b>	<b>8,931</b>	<b>10,047</b>	<b>13,092</b>	<b>15,160</b>	<b>17,597</b>	<b>17,986</b>	<b>CASH BALANCE</b>
<b>V.1</b>	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-8,931</b>	<b>-10,047</b>	<b>-13,092</b>	<b>-15,160</b>	<b>-17,597</b>	<b>-17,986</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
<b>V.2</b>	<b>Brendshëm</b>	<b>-9,154</b>	<b>-19,525</b>	<b>-22,154</b>	<b>-19,814</b>	<b>-26,455</b>	<b>-25,970</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	204	207	358	364	385	387	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,503	3,818	5,249	9,435	13,920	14,017	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	2,513	3,835	5,273	9,467	13,934	14,036	Other
2.2	Lokale	-10	-16	-24	-32	-14	-19	Foreign
3	Të tjera	-11,861	-23,550	-27,761	-29,613	-40,760	-40,374	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-499	-14,410	-11,935	-16,301	-30,275	-29,535	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-11,362	-9,140	-15,822	-13,312	-10,487	-10,836	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	-1,391	-4,083	-4,595	-4,261	-4,681	Deposits of Socila and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	-187	-93	-253	-649	1,590	1,654	Preservation stock
8	Nënhua	94	160	269	654	755	1,064	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	660	1,725	-287	1,152	934	146	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-432	-544	-568	-586	-600	-594	Other-Float
<b>V.3</b>	<b>I huaj</b>	<b>223</b>	<b>9,478</b>	<b>9,062</b>	<b>4,654</b>	<b>8,858</b>	<b>7,984</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	4,210	3,040	3,879	4,992	5,907	6,112	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	242	418	857	1,128	984	999	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-3,182	-2,020	-1,983	-1,860	-2,054	-2,039	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-805	-1,584	-2,876	-8,520	-10,021	-12,283	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	0	10042	10042	10042	15026	16.194	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2016**

Table of investments 2016

*Të dhëna progresive (Progressive Data)**në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor June	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>46</b>	<b>474</b>	<b>4,020</b>	<b>6,247</b>	<b>7,825</b>	<b>10,749</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	3.27	15.06	48.82	51.23	51.88	58.82	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,362</b>	<b>2,673</b>	<b>4,214</b>	<b>5,946</b>	<b>7,258</b>	<b>7,525</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	96.73	84.94	51.18	48.77	48.12	41.18	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>1,408</b>	<b>3,147</b>	<b>8,234</b>	<b>12,193</b>	<b>15,083</b>	<b>18,274</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2016 (CUSTOMS REVENUES 2016)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	
Taksë doganore	398	808	1,307	1,774	2,307	2,852	Customs Duties
TVSH	6,039	13,050	21,041	28,930	37,071	45,788	V.A.T
Akcizë	2,789	5,561	8,588	11,967	15,385	19,201	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	160	327	536	749	902	1,209	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>9,386</b>	<b>19,746</b>	<b>31,472</b>	<b>43,420</b>	<b>55,665</b>	<b>69,050</b>	<b>Total</b>

TË ARDHURAT TATIMORE 2015 (TAX REVENUE )
